



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:086978
Datë: 28.03.2024
Numri i dokumentit: 05515290

Pml.nr.61/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare e kolegjit, Afrim Shala dhe Agim Maliqi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarve: Rr.F. dhe B. F., që të dy nga fshati ..., komuna e Lipjanit, për shkak të veprës penale “*Shpërlarja e parave*”, nga neni 32, paragrafi 2, pikat 2.1., 2.3. dhe 2.8. të Ligjit për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizimit lidhur me nenet 31 dhe 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarve, të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, P.nr.335/2012, të datës 21.06.2023 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special, APS.nr.33/2023, të datës 22.09.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur më datë 29.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësve të të dënuarve: Rr. F. dhe B. F., të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.335/2012, i datës 21.06.2023 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, APS.nr.33/2023, i datës 22.09.2023.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, P.nr.335/2012, të datës 21.06.2023, të dënuarit: Rr. F. dhe B. F., secili veç e veç, janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale “*Shpërlarja e parave*”, nga neni 32, paragrafi 2, pikat 2.1., 2.3. dhe 2.8. të Ligjit për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizimit lidhur

me nenet 31 dhe 77 të KPRK-së dhe ndaj secilit prej të dënuarve, është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga një (1) vit e gjashtë (6) muajve dhe dënime me gjobë në shumë prej nga dhjetëmijë (10.000) euro, të cilat dënime, të dënuarit do t'i paguajnë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) diëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse të dënuarit: Rr. F. dhe B. F., nuk i paguajnë dënimet me gjobë të shqiptuara, atëherë konform nenit 43, paragrafi 3 të KPRK-së, këto dënime do t'ju zëvendësohen në dënim me burgim, ashtu që çdo njëzet (20) euro e dënimeve me gjobë do të llogaritet me një (1) ditë të dënimit me burgim.

Janë detyruar të dënuarit: Rr. F. dhe B. F., që secili veç e veç të paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe atë në emër të ekspertizës financiare shumë prej nga treqind (300) euro dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumë prej nga njëqind (100) euro, të gjitha këto, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti Special, me aktgjykimin APS.nr.33/2023, e datës 22.09.2023, i ka refuzuar si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, si dhe ankesat e mbrojtësve të të dënuarve: Rr. F. dhe B. F., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjytimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kanë paraqitur:

- mbrojtësja e të dënuarit Rr. F., avokatja Hedije Ademi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore dhe shkeljes së ligjit penal, duke propozuar që aktgjykimet e lartcekura të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, si dhe

- mbrojtësi i të dënuarit B. F., avokati Nebih Troshupa, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 1 të KPP-së, shkeljeve tjera esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore dhe shkeljes së ligjit penal, duke propozuar që aktgjykimet e lartcekura të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Kryeprokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresat KMLP.II.nr.34/2024, e datës 31.01.2024, ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësve të të dënuarve: Rr. F. dhe B. F., të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtoi të gjitha shkresat e lëndës dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, konstatoi se:

- kërkesat janë të pabazuara.

Fillimisht është e nevojshme të theksohet se kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarve: Rr. F. dhe B. F., janë në tërësi të njëjta, si në kuptim të arsyeve të paraqitura, ashtu edhe në kuptim të pretendimeve të ngritura, andaj edhe si të tilla, këto kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, në vijim do të paraqiten, elaborohen dhe vlerësohen bashkarisht.

Mbrojtësit e të dënuarve: Rr. F. dhe B. F., në kërkesat e tyre për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendojnë se aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, në radhë të parë për faktin se gjykatat në fjalë nuk kanë bërë vlerësimin e saktësisë së provave kundërthënëse, si dhe të arsyeve në të cilat janë bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprave penale dhe përgjegjësisë penale të të dënuarve, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të dënuarve dhe veprave penale. Sipas mbrojtësve të të dënuarve, vlerësimi i provave nuk është bërë, ashtu siç është parashikuar në nenin 360, paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, duke ju referuar këtu deklaramente të dëshmitarëve të dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, kurse në anën tjetër, në arsyetimet e aktgjykimeve të gjykatave të instancave më të ulëta fare nuk janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për cilat arsye janë konsideruar të vërtetuara, ndërsa ato që janë paraqitur, janë vërtetuar në mënyrë të njëanshme, në kundërshtim me nenin 7 të KPP-së. Në këtë rast, është shkelur edhe neni 8, paragrafi 2 i KPP-së, pasi që gjykatat nuk kanë marrë vendim në bazë të provave që janë shqyrtuar dhe verifikuar në shqyrtimit gjyqësor, duke ju referuar këtu provave materiale, kurse as vetë gjykata e shkallës së parë nuk është bindur se a e kanë ditur të dënuarit: Rr. F. dhe B. F., se paratë e pranuar nga S. P., burojnë nga veprimet kriminale.

Gjithashtu, mbrojtësit e të dënuarve: Rr. F. dhe B. F., kanë theksuar se në këtë rast është shkelur edhe ligji penal në dëm të të dënuarve, pasi që me asnjë provë materiale nuk është vërtetuar, qoftë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë, se të dënuarit i kanë kryer veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor.

Përveç faktit që kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë të njëjta, Gjykata Supreme e Kosovës, ka vërejtur se edhe pretendimet e mbrojtësve të të dënuarve: Rr. F. dhe B. F. nuk janë konkrete, pasi që në to, vetëm në mënyrë të përgjithësuar janë paraqitur disa aspekte që ndërliken me shkeljet e lartcekura.

Sidoqoftë, duke u bazuar në nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, Gjykata Supreme e Kosovës është kufizuar vetëm në verifikimin e këtyre pretendimeve të mbrojtësve të të dënuarve: Rr. F., dhe B. F., ashtu që pasi i shikoi shkresat e lëndës dhe analizoi pretendimet e lartcekura, konstatoi se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, nuk janë të përfshira me ndonjë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me shkelje të ligjit penal.

Në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë shihet qartë që janë paraqitur arsye të mjaftueshme për të gjitha pikat e aktgjykimit, ashtu siç është parashikuar në nenin 369, paragrafi 6 të KPP-së dhe se përshkrimet e dhëna në arsyetim, përmbajnë të gjitha arsyet për

faktet relevante të cilat janë paraqitur qartë dhe në asnjë mënyrë nuk paraqiten si kundërthënëse.

Përveç shumë aspekteve tjera të rëndësishme, në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë shihet që janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të mjaftueshme arsye, si për faktet kontestuese, ashtu edhe për ato jo kontestuese. Për të gjitha çështjet e rëndësishme, gjykata e shkallës së parë ka paraqitur arsye dhe elaborime të mjaftueshme, nga të cilat janë nxjerrë konkluzione caktuara, që i referohen si aspekteve juridike, ashtu edhe aspekteve faktike.

Përveç këtyre, edhe sa i përket aspektit subjektiv të veprave penale, gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të saj ka paraqitur arsyetime të mjaftueshme dhe të bazuara në prova, mbi bazën e të cilave është ardhur deri tek konkludimi se në këtë rast të dënuarit: Rr. F. dhe B. F., kanë vepruar me dashje dhe duke pasur arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, përkatësisht është fituar nga shmangia e tatimit, ndërsa të njëjtit, më pastaj kanë ndërmarrë veprimet inkriminuese të cilat janë të përshkruara në mënyrë të hollësishme në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerëson të pabazuar pretendimin e mbrojtësve të të dënuarve: Rr. F., dhe B. F., se nuk është vepruar konform nenit 360 dhe nenit 8, paragrafi 2 të KPP-së, pasi që nga shkresat e lëndës shihet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është bazuar vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor, duke përfshirë këtu dëgjimin e dëshmitarëve dhe ekspertit financiar, si dhe administrimin e një mori të provave materiale, ndërsa provat e tilla të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor rezulton se janë vlerësuar një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, si dhe në bazë të vlerësimit të tillë, janë nxjerrë përfundimet se faktet konkrete që kanë të bëjnë me këtë çështje penale janë provuar.

Përveç tjerash, përmes aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë rezulton se gjykata në fjalë ka përmbushur edhe detyrimet e saj për të paraqitur arsye edhe sa i përket çështjeve tjera, referuar nenit 369, paragrafit 7 të KPP-së. Në këtë drejtim, nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë shihet që janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh janë konsideruar të vërtetuara, si dhe janë paraqitur arsyet në të cilat, gjykata në fjalë është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprave penale dhe përgjegjësisë penale për secilin nga të dënuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal, duke përfshirë këtu çështjen e bashkëkryerjes dhe veprës penale në vazhdim.

Gjithashtu, edhe nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë rezulton se janë vlerësuar të gjitha pretendimet e rëndësishme ankimore të mbrojtësve të të dënuarve dhe janë paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të qarta sa i përket këtyre pretendimeve, por edhe sa i përket shkeljeve tjera për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, kështu që edhe në këtë drejtim, pretendimet e mbrojtjes rezultojnë të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës i konsideron të pabazuara edhe pretendimet në lidhje me shkeljen e ligjit penal, pasi që gjykatat e instancave më të ulëta, drejtë kanë vepruar kur të dënuarit: Rr. F. dhe B. F., secilin veç e veç i kanë shpallur fajtor për shkak të veprave penale

“Shpërlarja e parave”, nga neni 32, paragrafi 2, pikat 2.1., 2.3. dhe 2.8. të Ligjit për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizimit lidhur me nenet 31 dhe 77 të KPRK-së, sepse veprimet e të dënuarve në fjalë i përbëjnë të gjitha elementet subjektive (dashja dhe dijenia se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal) dhe objektive të këtyre veprave penale, siç është përshkruar në mënyrë të hollësishme në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Në fund, duhet theksuar se kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë përmbajnë edhe pretendime të caktuara që ndërlidhen me gjendjen faktike, mirëpo Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se konform neni 432, paragrafi 2 të KPP-së, ky mjet i jashtëzakonshëm juridik nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, andaj edhe rrjedhimisht pretendimet e tilla nuk janë shqyrtuar fare.

Duke u bazuar në arsyet e cekura më lart dhe në bazë të neni 437 të KPP-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.61/2024, më datë 29.02.2024

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Mejreme Memaj